



Datë: 08.05.2026

A.nr.445/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.445/2026, të datës 17.04.2026, të parashtruar nga ankueses B.M, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura *Krasniqi&Partners* kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 08.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar me ankesën A.nr.445/2026, të datës 17.04.2026, të parashtruar nga ankuesja B.M.

A r s y e t i m

Ankuesja, B.M (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 15.04.2026, përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill me datë 17.04.2026 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.445/2026, kundër Vendimit më numër Ref: DS-205/2026, të datës 26.03.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 29.04.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.04.2026; Parashtrësën e datës 29.04.2026; Vendim e datës 26.03.2026 me numër DS-205/2026; Kontratën e punës e datës 09.03.2026; Kërkesën e ankueses drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Autorizimin; Akt emërimit e datës 03.10.2017 me numër prot;527/7; Lista e pagave; Kopjen e letërnjoftimit; Kartelat Financiare. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të ofruara vetëm nga pala ankuese dhe shqyrtimit të përgjigjes me shkrim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullim të procedurës së filluar sipas ankesës A.nr.445/2026 të datës 17.04.2026, sepse:

I. Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se:

- Ankuesja sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar, të datës 03.10.2017, është e punësuar në pozitën *Bashkëpunëtor Profesional* në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
- Ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 23.02.2026 i është drejtuar me kërkesë organit të punësimit për kompensimin e pagës sipas përvojës së punës prej 0.25% në 0.5%.
- Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin me numër Ref: DS-205/2026 të datës 26.03.2026, ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 23.02.2026.
- Ankuesja me datë 17.04.2026, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK kundër Vendimit me numër Ref: DS-205/2026 të datës 26.03.2026.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Vendimi me numër Ref: DS-205/2026, i datës 26.03.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i pabazuar, dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të kompensohet diferenca e përvojës së punës në pagë prej 0.25% në 0.50% dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave fillimisht analizoj dispozitat ligjore që përcaktojnë kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e në këtë kontekst, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Rrjedhimisht, Kolegji mori parasysh edhe Aktgjykimin KO171/2019 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese, me theks të veçantë paragrafët 98 dhe 99, më të cilët është konstatua se: ... 98. E drejta për të nxjerr një ligj të posaçëm për rregullimin e shërbimit civil në Republikën e Kosovës, buron nga paragrafi 1 i nenit 101 të Kushtetutës, ndërsa e drejta për të nxjerr një ligj të posaçme për Këshillin buron nga paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, ...99... paragrafi 2 i nenit 101 ndërlihet ngushtë dhe është derivat i paragrafit 1, i cili në mënyrë specifike kërkon që zbatimi i normave juridikë që rregullojnë shërbimin civil do të mbikëqyret nga një “këshilli i pavarur mbikëqyrës”. Andaj, si rrjedhojë Gjykata Kushtetuese qartë ka saktësuar se fushëveprimi i Këshillit është i kufizuar dhe i lidhur ngushtë me ligjin bazik, respektivisht, me ligjin që rregullon shërbimin civil.

Bazuar si më sipër, Kolegji analizoj dispozitat e ligjit bazik nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë me theks të veçantë: Nenin 3: [Përfshijet nga fusha e zbatimit të ligjit] 1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji; 1.4. të emëruarat/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji. 2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim: 2.1. gjyqtarët/ët dhe prokurorët/ët; 2.2. personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse; 2.3. të punësuarat/it në Agjencinë Kosovare për Inteligjencë; 2.4. të punësuarat/it në Policinë e Kosovës; 2.5. të punësuarat/it në Inspektoratin Policor të Kosovës; 2.6. të punësuarat/it në Doganën e Kosovës; 2.7. të punësuarat/it në Njësinë për Inteligjencë Financiare; 2.8. drejtorin/in apo anëtarët/ët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatore; 2.9. personelin e ndërmarrjeve publike, në pronësi të Qeverisë apo të komunës. -**Nenin 5, paragrafi 2:** 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë...” dhe Nenin 6, paragrafi 4: Të punësuarat/it e administratës në kuadër të **sistemit të drejtësisë**, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.

Po ashtu, në ndërlidhje me kuadrin ligjor si më lart, Kolegji iu referuar edhe nenit 4 të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku parashihet se: . Në paragrafin 2. të nenit 3 të ligjit bazik pas nën-paragrafit 2.9. shtohen nën-paragrafët si në vijim: 2.10. të punësuarit në Agjencinë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar; 2.11. të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës; 2.12. të punësuarit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigimit Ajror; 2.13. të punësuarit në Këshillin e Sigurisë së Kosovës; 2.14. të punësuarit në Bankën Qendrore të Kosovës; 2.15. të punësuarit në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës; 16. të punësuarit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore; 2.17. të punësuarit në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë; 2.18. zyrtarët korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës. 2. Në nenin 3 të ligjit bazik

shtohet një paragraf i ri 3. si në vijim: 3. Përveç institucioneve të përcaktuara në këtë nen, institucionet e tjera publike mund të përjashtohen nga fushëveprimi i këtij ligji vetëm nëse një gjë e tillë parashihet shprehimisht në ligjin e veçantë..”

Rrjedhimisht, në kuptim të bazës ligjor si më sipër, Kolegji vlerëson se përjashtimisht gjyqtareve, të punësuarit tjerë në sistemin gjyqësor duke përfshirë këtu edhe bashkëpunëtorët profesional janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe ndaj tyre aplikohen rregullat e shërbimit civil, pasi që më asnjë dispozitë të ligjit të veçantë nuk janë të përjashtuar si kategori.

Kolegji thekson faktin se KGJK-ja më datë 15 nëntor 2021 ka miratuar Rregulloren Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës. Përveç tjerash më dispozitat e kësaj rregullore përkatësisht më nenin 28 është përcaktuar se: *1. Kandidati i suksesshëm pas përzgjedhjes nga Komisioni për Rekrutim lidh kontratë të punës me Këshillin, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës. 2. Kontrata e punës lidhët për kohë të pacaktuar dhe konfirmohet pas përfundimit më sukses të periudhës provuese”,* ndërsa, më nenin 30, paragrafi 5 të kësaj rregullore përcaktohet se: *Bashkëpunëtori profesionale, sipas legjislacionit në fuqi, ka të drejtë të iniciojë procedurë në gjykatën kompetente ndaj vendimit përfundimtar të Këshillit për mos-konfirmim të pozitës pas periudhës provuese.*

Andaj, meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit normativ siç është Rregullorja Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit/Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, dhe duke pas parasysh situatën juridike të krijuar sipas kësaj rregullore lidhur me statusin e pozitës së bashkëpunëtorit profesional në gjykata, Kolegji më qëllim të ruajtjes së pavarësisë funksionale dhe organizative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të garantuar më Kushtetutë, vlerëson që në kuptim të dispozitave të nenit 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative procedura lidhur me këtë çështje administrative të pezullohet deri në definimin e statusit të pozitës së bashkëpunëtorit profesional (në gjykatë) nga organet gjyqësore. Rrjedhimisht, çështja e vlerësimit të Rregullores Nr.04/2021 për Procedurën e Rekrutimit/Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, është iniciuar përmes kontestit administrativ të paditësit B. B dhe se procesi gjyqësor gjendet në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, sipas aktvendimit AA.nr.308/2024, të datës 12.11.2025, të Gjykatës së Apelit.

Bazuar në të gjeturat e lart theksuara, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se me evitimin e rrethanave që kanë sjellë pezullimin e kësaj procedure, Kolegji do të vendos në mënyrë meritore lidhur me ankesën e pezulluar sipas këtij vendimi.

Siç u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.445/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses se autorizuar Avokatura Krasniqi&Partners;
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës: Kryesuesit-es të KGJK-së, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.